



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi e Zbatuar

Ngarkesa : 3 kredite, 30 orë, 15 leksione dhe 15 seminare

Viti akademik/semestri kur zhvillohet : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës : Lëndë e detyrueshëm

Programi i studimit : Master i shkencave në “Mësuesi”, (për vitin e parë)

Kodi i etikës : Kodi i etikës i Universitetit të Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit :

Në këtë lëndë do të analizojmë arritjet dhe nocionet e gjuhësisë, rendimenti i të cilave është dëshmuar tashmë në didaktikën e gjuhëve. Në program përfshihen disa aspekte të gjuhësisë kontrastive (interferencat...), gjuhësia e zbatuar për përvetësimin e fjalorit, të gramatikës, të shkrimit, të shqiptimit, të frëngjishtes së folur, etj. Tematika e programit pasurohet gjithashtu me gjuhësinë e zbatuar për përsosjen e frëngjishtes (nivel i përparuar, fjalori teknik, qytetërimi...), me “kurthet” e gjuhës frënge dhe rolin e fjalorëve në mësimin e frëngjishtes. Afritë dhe dallimet mes frëngjishtes dhe shqipes do të trajtohen gjithashtu në këtë lëndë...

Objektivat e përgjithshëm të lëndës:

Kjo lëndë synon t’u japë studentëve të vitit të parë (Master i shkencave në “Mësuesi”), të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (Universiteti i Tiranës), nocionet themelore të gjuhësisë dhe zbatimin e tyre në metodikën e mësimdhënies së frëngjishtes-gjuhë e huaj.

Edhe pse zbatimi i teorive dhe koncepteve gjuhësore në metodikën e mësimdhënies nuk është gjithmonë i thjeshtë, didakticienët dhe profesorët e gjuhëve të huaja duhet të mbështeten në shkencat gjuhësore për konceptimin dhe përpilimin e mjeteve pedagogjike.

Objektivat specifike të lëndës:

- Të nxjerrim në pah lidhjet që ekzistojnë midis shkencave gjuhësore nga njëra anë dhe përvetësimit të gjuhëve të huaja (të frëngjishtes në rastin tonë) nga ana tjetër.
- T’u lejojmë studentëve të strukturojnë më mirë nocionet gjuhësore dhe praktikatat pedagogjike.
- Në përfundim të programit të propozuar, studentët duhet të njohin afritë dhe dallimet kryesore mes frëngjishtes dhe shqipes.